



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane - Ministry of Defense



STRATEGJIA E MBROJTJES E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS



2023

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
1. MJEDISI I SIGURISË.....	5
1.1. GLOBAL	5
1.2. RAJONAL.....	5
1.3. MJEDISI I BRENDSHËM	6
1.3.1 SFIDAT, KËRCËNIMET/RREZIQET	6
2. POLITIKAT E MBROJTJES NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	9
2.1. VLERAT DHE INTERESAT SHITETËRORE	10
2.2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË SË MBROJTJES.....	11
3. SISTEMI I MBROJTJES NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.....	11
3.1 ORGANIZIMI I SISTEMIT TË MBROJTJES	12
3.2 PRIORITETET E SISTEMIT TË MBROJTJES	12
3.3 ELEMENTET E SISTEMIT TË MBROJTJES DHE ROLI I TYRE	13
4. ZHVILLIMI DHE MODERNIZIMI I AFTËSIVE DHE KAPACITETEVE TË MBROJTJES.....	15
4.1.AFTËSITË DHE KAPACITETET E MBROJTJES	15
4.1.1.Ministria e Mbrojtjes	17
4.1.2.Forca e Sigurisë e Kosovës	17
4.2. ZHVILLIMI DHE MODERNIZIMI I SISTEMIT TË MBROJTJES.....	20
5. BURIMET DHE BUXHETI I MBROJTJES.....	21
6. PËRFUNDIM.....	23

SHKURTESAT

RKS Republika e Kosovës

QRK Qeveria e Republikës së Kosovës

MM Ministria e Mbrojtjes

FSK Forca e Sigurisë e Kosovës

SHBA Shtetet e Bashkuara të Amerikës

PAZH Plani Afatgjatë Zhvillimor

PGJT Plani Gjithëpërfshirës i Transformimit

SSK Strategjia e Sigurisë së Kosovës

SM Strategjia e Mbrojtjes

NATO North Atlantic Treaty Organisation.

BE Bashkimi Evropian

NALT Nato Advisory Liaison Team

PBB Prodhimi i Brendshëm Bruto

MUAC Mbështetja Ushtarake e Autoriteteve Civile

PPBE Planifikim, Programim, Buxhetim dhe Ekzekutim

BNJ Burimet Njerëzore

EOD Explosive Ordnance Disposal (Asgjësimi i Mjeteve Shpërthyes)

AMIS Agjencia e Mbrojtjes për Inteligjencë dhe Siguri

Hyrje

Strategjia e Mbrojtjes është dokument publik, që adreson çështjet më të rëndësishme në fushën e funksionimit dhe të zhvillimit të sistemit të mbrojtjes në Republikën e Kosovës. Strategjia e Mbrojtjes rrjedh nga legjislacioni në fuqi, i bazuar në mandatin e ri të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës. Po ashtu, ajo mbështetet në Strategjinë e Sigurisë së Kosovës dhe në perspektivën e integritit të Republikës së Kosovës në organizmat rajonalë dhe ndërkombëtarë të fushës së mbrojtjes dhe të sigurisë.

Strategjia e Mbrojtjes ofron vizion afatmesëm për atë se si Republika e Kosovës do të zbatojë funksionin themelor të mbrojtjes - ruajtjen e pavarësisë, integritetin territorial dhe sovranitetin. Strategjia e Mbrojtjes përcakton strukturën, menaxhimin dhe parimet e funksionimit të sistemit të mbrojtjes në kohë paqeje, në situata emergjente, në kohë krize dhe në kohë lufte.

Bazuar në sfidat, kërcënimet dhe rreziqet e identifikuara për sigurinë dhe mbrojtjen, Strategjia e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës përcakton qëllimin dhe objektivat strategjike të mbrojtjes. Ajo përshkruan në tërësi sistemin e mbrojtjes dhe misionet dhe detyrat e Forcës së Sigurisë të Kosovës. Strategjia e Mbrojtjes ofron vizionin e zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve të mbrojtjes, parimet e organizimit të sistemit të mbrojtjes, si dhe burimet e nevojshme të mbrojtjes.

Strategjia e Mbrojtjes ofron udhëzime strategjike për zhvillimin, modernizimin dhe standardizimin e sistemit të mbrojtjes të Republikës së Kosovës.

Pikë fillestare e Strategjisë së Mbrojtjes është vlerësimi i mjedisit të sigurisë dhe mbrojtja e Republikës së Kosovës. Strategjia është kornizë për funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të mbrojtjes. Është dokument që aplikohet dhe përditësohet në varësi të mjedisit të sigurisë, interesave shtetërore, mundësive ekonomike dhe progresit të Republikës së Kosovës në iniciativat rajonale të bashkëpunimit për siguri dhe mbrojtje, si dhe integrimin në NATO dhe në BE.

Strategjia e Mbrojtjes është bazë për zhvillimin e sistemit të mbrojtjes, duke përfshirë përgatitjen e planeve të mbrojtjes, planet e zhvillimit të FSK-së. Gjithashtu, është bazë për planet e modernizimit dhe të standardizimit të pajisjeve të FSK-së, si dhe përgatitjen e dokumenteve të tjera në fushën e funksionimit dhe zhvillimit të sistemit të mbrojtjes në përgjithësi dhe të Forcës së Sigurisë të Kosovës në veçanti. Për më tepër, Strategjia e Mbrojtjes harmonizohet me Planin e Reagimit Kombëtar dhe dokumentet e tjera strategjike që ndërlidhen me mbrojtjen dhe sigurinë.

Buxheti i Republikës së Kosovës dhe mbështetja nga partnerët përcaktojnë zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve të mbrojtjes. Ngritja e kapaciteteve të mbrojtjes në periudhën e ardhshme do të realizohet përmes rritjes graduale të buxhetit të mbrojtjes.

Strategjia e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes. Zbatimi i Strategjisë së Mbrojtjes mbështetet me Planin e Veprimit.

1. Mjedisi i sigurisë

1.1. Global

Mjedisi global i sigurisë vazhdon të mbetet i paqëndrueshëm, i pasigurt, kompleks dhe i paqartë. Bota përballet me sfida, kërcënime dhe rreziqe, të cilat ndryshojnë në suaza të kohës, gjeografisë, zhvillimit të gjithmbarshëm teknologjik, globalizimit, kërkesave për resurse dhe konfrontimit të interesave nacionale të shteteve. Në këtë dekadë janë shndërruar në realitet aspiratat për pushtime territoriale nga vendeve të ndryshme përfshi vende në kontinentin evropian. Agresioni Rus kundrejt Ukrainës ka shpërfaqur dhe rritur rrezikun që edhe vende tjera me aspirata të njëjta si Rusia të ndërmarrin veprime territoriale ndaj vendeve të pavarura dhe sovraane. Kompleksiteti i shtuar në mjedisin global të sigurisë ka ndikim të ndjeshëm në Evropë dhe gjithashtu në rajonin tonë. Mjedisi gjeopolitik dhe global i sigurisë përbën kërcënime dhe mundësi, të cilat ndikojnë në përcaktimin e politikave të sigurisë dhe të interesave shtetërore të Republikës së Kosovës. Evoluimi i mjedisit global të sigurisë mbetet një nga faktorët vendimtarë me ndikim të drejtpërdrejtë në formësimin e institucioneve të sigurisë dhe të mbrojtjes.

Në spektrin e kërcënimeve, rreziqeve dhe sfidave aktuale të sigurisë, theksi vihet në: çështjet e pazgjidhura ndërshtetërore, kërcënimet hibride, rikthimin e konkurrencës ideologjike, terrorizmit ndërkombëtar, krimin të organizuar, korrupsionit, përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, kërkesave gjithnjë në rritje për resurse natyrore, mosmarrëveshjeve fetare dhe etnike, ekstremizmit kombëtar dhe fetar, fatkeqësive natyrore dhe të shkaktuara nga faktori njeri, epidemive, pandemive dhe endemive, dallimeve socio-ekonomike, si dhe krimin kibernetik. Këto kërcënime/rreziqe vazhdimisht ndryshojnë formë dhe karakterizohen nga kohëzgjatja, paparashikueshmëria, natyra jo proporcionale dhe dinamike. Kjo i detyron strukturat e sigurisë dhe të mbrojtjes që të orientohen në krijimin e aftësive dhe të kapaciteteve për të reaguar në mënyrë efikase dhe efektive.

1.2. Rajonal

Pas luftërave dhe konflikteve që e shoqëruan procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë, niveli i sigurisë dhe qëndrueshmëria e rajonit është përmirësuar. Prania e organizmave të NATO-s dhe të BE-së në rajon vazhdon të mbetet faktor në ruajtjen e paqes dhe të qëndrueshmërisë rajonale. Megjithatë, mjedisi i sigurisë i rajonit të Ballkanit Perëndimor është dhe pritet të jetë një mjedis në zhvillim dinamik, për sa i përket kërcënimeve dhe rreziqeve të sigurisë. Lufta në Ukrainë, ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë dhe efekte dytësore negative në aspektin ekonomik dhe atë të sigurisë në tërë rajonin tonë. Në aspektin e sigurisë, Kosova u prek nga lufta hibride e Rusisë, e cila së bashku me Serbinë, kanë për qëllim ngritjen e tensioneve në veri të vendit dhe potencialisht mundë të rezultojë në një konflikt ndëretnik. Tendencat e ngjashme të destabilizimit janë vërejtur edhe në vende tjera të rajonit, përfshirë Malin e Zi dhe Bosnje e Hercegovinën. Pavarësisht këtyre tendencave, vendet e rajonit kanë treguar qëndrueshmëri falë orientimit euroatlantik dhe partneritetit të ngushtë me SHBA.

Natyrë e sfidave bashkëkohore të sigurisë dhe zhvillimet gjeopolitike kanë bërë që Republika e Kosovës të mos e mbështesë mbrojtjen e saj vetëm në kapacitetet e brendshme. Prandaj, Strategjia e Mbrojtjes mbështetet në perspektivën e integritimit të Republikës së Kosovës në organizmat rajonale dhe ndërkombëtarë të fushës së mbrojtjes dhe sigurisë.

Trendët kryesorë (kërcënimet/rreziqet dhe mundësitë) që do ta karakterizojnë Ballkanin Perëndimor brenda kornizës kohore afatmesme.¹ janë:

- Vazhdojnë të jenë të pranishme qëllimet politike për hegjemoni nga Serbia – “Projekti ideor Bota Serbe” ;
- Pretendimet territoriale dhe kontestet ndërmjet shteteve të ish-Jugosllavisë dhe më gjerë në rajon;
- Garat për armatim, duke shfrytëzuar çdo mundësi për të rritur fuqinë luftarake;
- Cenimi i rendit kushtetues të ndonjë shteti apo shteteve të rajonit;
- Ndikimi i akterëve shtetërorë dhe jo shtetërorë të huaj në Ballkanin Perëndimor;
- Etnocentrizmi;
- Konsolidimi i pamjaftueshëm i demokracisë;
- Trendet demografike;
- Proceset integruese në aleanca, koalicione dhe iniciativa (Integrimi në BE dhe në NATO i shteteve të Ballkanit Perëndimor);
- Bashkëpunimi rajonal.

1.3. Mjedisi i brendshëm

Proceset integruese të vendeve të rajonit në NATO dhe në BE, si dhe zhvillimi i politikave të mirëbesimit, bashkëpunimit dhe partneritetit, kanë zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme mundësinë e kërcënimit të drejtpërdrejtë ushtarak ndaj Republikës së Kosovës, por ky rrezik nuk është eliminuar plotësisht. Bazuar në treguesit politikë, ekonomikë dhe shoqërorë, si dhe në vlerësimet e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, mjedisi i sigurisë në Republikën e Kosovës është relativisht i qëndrueshëm. Në këtë kuadër, thelbësore mbesin prania e NATO dhe BE në Kosovë, si dhe zhvillimi i kapaciteteve të Kosovës në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Mirëpo, kërcënimet dhe rreziqet nuk janë të lidhura vetëm me përdorimin e forcës konvencionale ushtarake, por edhe me kërcënimet dhe rreziqet asimetrike dhe hibride, të cilat mund të ndikojnë në sigurinë e Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës, me gjithë zhvillimet pozitive, kërcënohet, rrezikohet dhe sfidohet nga: qasja armiqësore e Serbisë, ndërhyrjet e jashtme, sulmet kibernetike, ekstremizmi nacional dhe fetar, fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

1.3.1 Sfidat, kërcënimet/rreziqet

Qasja e Serbisë ndaj Republikës së Kosovës

Republika e Serbisë mbështetur nga Rusia, vazhdon të mbetet kërcënimi më serioz dhe kryesor ndaj sigurisë shtetërore të Republikës së Kosovës. Serbia në vazhdimësi ka demonstruar që ka aftësitë, kapacitetet si dhe synimin për të qar përpara interesat e saj duke cenuar interesat si dhe sigurinë shtetërore të Republikës së Kosovës. Republika e Serbisë vazhdon të përdorë në mënyrë të sinkronizuar të gjitha elementet e saja përmes metodave hibride² kundër Republikës së Kosovës. Në fushën e diplomacisë ndërkombëtare, ajo vepron kundër shtetësisë dhe integritetit të Republikës së Kosovës në institucionet ndërkombëtare.

¹ Afatmesme, periudha kohore pesë (5) vjeçare

² A NATO definition is “Hybrid threats combine military and non-military as well as covert and overt means, including disinformation, cyber attacks, economic pressure, deployment of irregular armed groups and use of regular forces. Hybrid methods are used to blur the lines between war and peace, and attempt to sow doubt in the minds of target populations. The speed, scale and intensity of hybrid threats have increased in recent years”.

Në territorin e Republikës së Kosovës, ajo përdor elemente informative dhe ekonomike për ta instrumentalizuar pakicën serbe dhe për t'i fuqizuar strukturat paralele, duke penguar procesin e integritetit të tyre. Në të njëjtën kohë, Serbia vazhdon të paraqesë rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë e Republikës së Kosovës, duke zhvilluar, modernizuar dhe rritur kapacitetet ushtarake, si dhe pozicionimin e tyre përgjatë kufirit me Kosovën. Disa nga këto sfida rezultojnë nga mungesa e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Veprimtaritë destabilizuese të shërbimeve të huaja të inteligjencës

Veprimtaritë e ndryshme (malinje), përmes operacioneve të tyre të fshehta, të cilat janë të fokusuar në pengimin e proceseve demokratike në Kosovë, paraqesin rrezik real për shtetin dhe për institucionet e Kosovës.

Veprimtaritë influencuese dhe dezinformuese të shërbimeve informative dhe të sigurisë së shteteve dhe akterëve jo shtetërorë përbëjnë kërcënim në rritje. Këta akterë përdorin tërësi mjetesh dhe mekanizmash (financim të strukturave kriminale, organizata joqeveritare, mjete të informimit), si dhe operacione të inteligjencës për të dëmtuar imazhin dhe interesat e Republikës së Kosovës.

Sulmet kibernetike

Sulmet kibernetike përbëjnë rrezik serioz ndaj Kosovës dhe sigurisë globale. Gjatë vitit 2022 janë regjistruar disa sulme kibernetike kundër institucioneve shtetërore në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimorë.

Gjatë viteve në vijim pritet rritje e numrit dhe ashpërsisë së sulmeve kibernetike të gjeneruara nga akterë shtetërorë dhe jo shtetërorë. Këto kërcënime kanë karakter ndërkombëtar dhe kërkojnë përgjigje globale dhe të bashkërenduara.

NATO-ja dhe BE-ja, në vitet e fundit, i kanë bashkërenduar aktivitetet në Evropën Juglindore. Strategjia shtetërore për siguri kibernetike adreson masat që do të ndërmerren për mbrojtje kibernetike. Republika e Kosovës duhet të fokusohet në ngritjen e aftësive dhe kapaciteteve për mbrojtje kibernetike.

Ekstremizmi nacional dhe fetar

Kosova është pjesë e koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit dhe është e përkushtuar që të japë kontribut të vazhdueshëm në trajtimin dhe në luftimin e kësaj dukurie. Republika e Kosovës mbetet e ekspozuar ndaj ekstremizmit i cili mund të jetë me natyrë nacionaliste dhe fetare.

Ekstremizmi me natyrë nacionaliste në vend është më shumë i pranishëm në ato rajone ku ndarja mbi baza etnike është më e theksuar.

Keqpërdorimet e qëllimshme ideologjike Islame apo Pravosllave - Ortodokse Serbe shërbejnë si bazë për përhapjen e qëndrimeve ekstremiste të cilat mund të përshkallëzohen duke u shndërruar në një kërcënim real për prishjen e stabilitetit të brendshëm në vend dhe kryerjen e akteve terroriste.

Fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri, si ndryshimet mjedisore, klimatike dhe zhvillimet teknologjike, të cilat ndikojnë te njerëzit, infrastrukturën kritike dhe shtetin, pritet të karakterizojnë mjedisin e ardhshëm të sigurisë.

Ndotja e mjedisit, kufizimi i burimeve, rreziqet për shëndetin, ndryshimet e klimës, mungesa e ujit përbëjnë rrezik për sigurinë e vendit. Fatkeqësitë natyrore si: tërmetet, përmytjet, bllokimet nga

dëbora, rrëshqitjet, zjarret masive, si dhe epidemitë, pandemitë dhe endemitë e ndryshme, gjithashtu, mund të kenë ndikim në mjedisin e sigurisë.

Kërcënime të tjera mund të shkaktohen edhe nga: avaritë industriale, nga pakujdesia e faktorit njeri, si dhe nga veprimet e qëllimshme sabotuese, kriminale dhe terroriste.

Pasojat e këtyre dukurive mund të përfshijnë dhe të rrezikojnë territoret e vendeve fqinje dhe, në të njëjtën formë, mund të shtrihen nga vendet fqinje në Republikën e Kosovës, duke e rrezikuar territorin dhe popullsinë e saj.

Pamundësia e autoriteteve civile për përballimin e këtyre sfidave mund të kërkojë angazhimin e komponentit ushtarak. Pamundësia e identifikimit dhe parashikimit në kohë të këtyre sfidave, kërcënimeve/rreziqeve detyron strukturat e sigurisë dhe të mbrojtjes të Republikës së Kosovës të ndërtojnë aftësi dhe kapacitete që, në kohën më të shkurtër të mundshme, të reagojnë me efektivitet dhe me sukses ndaj këtyre sfidave dhe kërcënimeve/rreziqeve.

2. Politikat e Mbrojtjes në Republikën e Kosovës

Politikat e Mbrojtjes, të shprehura në Strategjinë e Mbrojtjes, mbështeten në vlerat e Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe në parimet themelore të mbrojtjes dhe të sigurisë të shprehura në Strategjinë e Sigurisë së Kosovës.

Këto politika kanë për qëllim të identifikojnë masat për mbrojtjen e interesave dhe objektivave të sigurisë shtetërore: pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial; rendin kushtetues; zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik; jetën, mirëqenien, pronën dhe sigurinë e qytetarëve; qëndrueshmërinë rajonale dhe anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

Prania e mekanizmave të NATO-s në Kosovë ka ndikuar pozitivisht në ruajtjen e paqes dhe të sigurisë jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon. Kjo prani kontribuon në forcimin dhe në zhvillimin e kapaciteteve të mëtutjeshme të Republikës së Kosovës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Andaj është me rëndësi që të vazhdoi kjo prani, dhe Kosova së bashku me partnerët, të ndërtoj arkitekturën e saj të sigurisë.

Ministria e Mbrojtjes do të forcoj edhe më shumë bashkëpunimin me NATO-në përmes NALT dhe do të intensifikohet bashkëpunimi me shtetet anëtare të NATO-së në mënyrë që të maksimizohen të gjitha mundësitë që e vendosin Republikën e Kosovës më afër anëtarësimit të plotë në NATO ndërsa në planin afatshkurtër, Kosovës t'i hapet mundësia e anëtarësimit në PfP.

Në fushën bilaterale do të punohet që harta e bashkëpunimit të rritet edhe më shumë, posaçërisht me shtetet anëtare të NATO-së dhe BE-se. Gjithashtu, do të punohet që të arrihen sa më shumë marrëveshje bilaterale në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe marrëveshje për SOFA.

Është me rëndësi që në përputhje me Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, me mbështetjen dhe ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë, të vazhdohet edukimi dhe trajnimi i FSK-së sipas standardeve të NATO-së, pasi që do të rriste ndërveprueshmërinë me ushtritë e vendeve partnere. Ministria e Mbrojtjes në koordinim dhe bashkëpunim me MPJD do të angazhohet në zgjerimin e rrjetit të atasheve të mbrojtjes në të gjitha kontinentet.

Ministria e Mbrojtjes synon të përmirësojë dhe të ndërtojë një sistem të mbrojtjes dhe sigurisë me kapacitetet e nevojshme, me ndërthurje të elementeve të fuqisë shtetërore, (Diplomacisë, Informacionit, Ushtrisë, Ekonomisë, Financave, Inteligjencës dhe sundim të Ligjit).

Institucionet e sigurisë dhe të mbrojtjes do të veprojnë nën konceptin strategjik të mbrojtjes, që ka për qëllim bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet autoriteteve ushtarake dhe civile në kohë paqeje, situata emergjente, krize apo lufte, duke siguruar orientimin e të gjitha kapaciteteve në dispozicion për mbrojtjen e interesave të vendit.

Me integrimin në organizmat rajonale e ndërkombëtarë të Republikës së Kosovës, Ministria e Mbrojtjes do të jetë pjesë e arkitekturës rajonale dhe globale të sigurisë.

Forca e Sigurisë së Kosovës synon të jetë pjesëmarrëse në stërvitjet e përbashkëta ushtarake me shtetet anëtare ose partnere të NATO-s; synon pjesëmarrjen në operacione ndërkombëtare, si dhe në organizata dhe forume rajonale të mbrojtjes dhe të sigurisë, duke siguruar qasje të vazhdueshme

në qendrat e arsimit dhe të stërvitjes të NATO-s. Republika e Kosovës do të ndjekë me kujdes të gjitha procedurat e aplikimit si vend partner, aspirant, kandidat apo anëtar me të drejta të plota në këto organizata, si dhe do të angazhohet në respektimin e parimeve bazë, që aplikohen për anëtarët dhe të gjitha shtetet partnere të NATO-s.

Partneriteti me vendet e rajonit për çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë, me qëllim të përshpejtimit të procesit të integritimit në NATO dhe në BE, mbetet prioritet i Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Ministria e Mbrojtjes do të angazhohet në krijimin e qasjes “Smart Defense” me shtetet e rajonit për të ndërtuar kapacitete të përbashkëta dhe të ndërveprueshme, në fushën e sistemit të armëve, mirëmbajtjes, shkollimeve ushtarake dhe emergjencave civile.

Partneriteti strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës është garantues i interesave jetike të vendit. Roli i SHBA-së është veçanërisht i madh në lehtësimin e integritimit në NATO, në nismat rajonale dhe në zhvillimin e sektorit të mbrojtjes dhe sidomos të FSK-së. Ministria e Mbrojtjes do të avancoi bashkëpunimin edhe më shumë me Departamentin e Mbrojtjes së SHBA-ve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes përmes dokumenteve strategjike si dhe të avancoi bashkëpunimin me Gardën Kombëtare të Iowa-s.

Forca e Sigurisë e Kosovës do të konsolidohet dhe do të zhvillohet edhe më tej, si forcë ushtarake profesionale dhe do të jetë kapacitet ushtarak me të cilin Republika e Kosovës do të garantojë mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial, si dhe pjesëmarrjen në operacione ndërkombëtare. Mbajtja dhe zhvillimi i kapaciteteve të FSK-së dhe institucioneve të tjera të sigurisë, në mbështetje të autoriteteve civile, është një objektivi i rëndësishëm i Republikës së Kosovës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

Strategjia e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës përcakton synimin për modernizimin e FSK-së sipas standardeve të vendit, të NATO-s dhe të BE-së. Bazuar në Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, Republika e Kosovës do t’i kushtojë vëmendjen e duhur mbështetjes me resurse të FSK-së. Prioritet do t’u jepet modernizimit, trajnimit dhe arsimit të personelit, si dhe mbështetjes së pjesëmarrjes në operacionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

2.1. Vlerat dhe interesat shtetërore

Vlerat kryesore që e karakterizojnë Republikën e Kosovës janë të paraqitura në kapitullin e shtatë të Kushtetutës së Republikës të Kosovës. Rendi kushtetues është i bazuar në parimin e lirisë, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave të njeriut, rendit dhe ligjit, të drejtës së pronës, ruajtjes së mjedisit, pluralizmit, ndarjes së pushtetit dhe ekonomisë së tregut.

Këto vlera shtetërore, të paraqitura në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, tregojnë orientimin euroatlantik të vendit tonë. Cenimi i këtyre vlerave është bazë për aktivizimin e komponentëve të fuqisë shtetërore.

Kategorizimi i interesave shtetërore është shumë i rëndësishëm për vlerësimin e mjedisit të sigurisë dhe për përcaktimin e platformave dhe politikave efikase të sigurisë shtetërore në kohë dhe në mënyrë sistematike, si dhe përcaktimin e kërcënimeve/rreziqeve në terma afatgjatë ndaj interesave dhe sigurisë shtetërore.

Siç janë përcaktuar në Strategjinë e Sigurisë së Kosovës, interesat kryesore shtetërore të Republikës së Kosovës janë:

- Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial;
- Ruajtja e rendit kushtetues dhe siguria publike;
- Siguria njerëzore dhe zhvillimi shoqërorë;
- Integrimi në strukturat euro-atlantike dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë.

Republika e Kosovës është e orientuar drejt integriteteve euroatlantike dhe e përqendruar në mbrojtjen e interesave të saj shtetërore dhe në arritjen e objektivave të Mbrojtjes dhe të Sigurisë, bazuar në parimin e respektimit të normave dhe ligjeve ndërkombëtare. Republika e Kosovës do të përdorë të gjitha kapacitetet dhe burimet në dispozicion për të mbrojtur interesat e saj shtetërore.

2.2. Qëllimi dhe objektivat e Strategjisë së Mbrojtjes

Qëllimi i Strategjisë së Mbrojtjes është ofrimi i drejtimeve kryesore për organizimin, zhvillimin dhe funksionimin e sistemit të mbrojtjes, për t'iu përgjigjur kërcënimeve/rreziqeve në Republikën e Kosovës. Strategjia e Mbrojtjes jep drejtime dhe udhëzime për zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve për të mbrojtur dhe ruajtur qytetarët, lirinë, pavarësinë, sovranitetin dhe territorin e Republikës së Kosovës.

Objektivat e Strategjisë së Mbrojtjes janë përcaktuara duke u bazuar në interesat shtetërore. Këto objektiva do të përmbushen në planin afatmesëm dhe afatgjatë. Niveli i përmbushjes së tyre do të bëhet në përputhje me prioritetin e interesave kombëtare, me kërkesat njerëzore, materiale dhe financiare që lidhen me to, si dhe mundësitë konkrete në zhvillim të Republikës së Kosovës në periudhën afatmesme.

Objektivat strategjike të mbrojtjes:

1. Mbrojtja e sovraniteti dhe integritetit territorial të vendit
2. Modernizimi dhe avancimi i kapaciteteve ushtarake
3. Rritja e ndërveprueshmërisë ndërinstitucionale
4. Zgjerimi i bashkëpunimit bilateral, anëtarësimi në organizata dhe pjesëmarrja në operacione ndërkombëtare.
5. Avancimi i bashkëpunimit me NATO-në dhe mekanizmat e saj në Kosovë

3. Sistemi i mbrojtjes në Republikën e Kosovës

Siç është theksuar në Strategjinë e Sigurisë së Kosovës, sistemi i mbrojtjes në Republikën e Kosovës bazohet në vlera dhe në parime të Kushtetutës dhe të legjislacionit në fuqi. Kjo qasje merr për bazë arkitekturën e sigurisë, që është zhvilluar dhe definuar në Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë dhe ka për qëllim që të zhvillojë kapacitete për të vepruar si e pavarur dhe e ndërveprueshme me partnerë strategjikë.

Ministria e Mbrojtjes ka për qëllim që të sigurojë një përgjigje ndaj sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë, si dhe t'u përshtatet ndryshimeve në mjedisin modern të sigurisë. Kjo nënkupton një qasje gjithëpërfshirëse dhe një kontribut të të gjitha elementeve të sigurisë dhe të mbrojtjes në Republikën e Kosovës.

Sistemi i mbrojtjes i Republikës së Kosovës mbështetet në arkitekturën e sigurisë, që nënkupton se ekziston linjë e qartë ligjore e inicimit të angazhimit, detyrave, komandimit dhe drejtimit, aftësive dhe kapaciteteve të zotuar në operacione sipas skenarëve nga Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë në Kosovë.

Sistemi i mbrojtjes mbështetet në bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet autoriteteve ushtarake dhe civile, në kohë paqeje, situata emergjente, krize dhe lufte, me qëllim të sigurimit dhe të orientimit të të gjitha kapaciteteve në dispozicion për mbrojtjen e vendit.

Ky sistem gjithashtu merr për bazë edhe mbështetjen e partnerëve dhe aleatëve, në kohë paqeje, situata emergjente, krize apo lufte.

3.1. Organizimi i sistemit të mbrojtjes

Republika e Kosovës e organizon sistemin e mbrojtjes me aftësitë dhe kapacitetet e institucioneve të vendit në dispozicion, si dhe ato që planifikohen të zhvillohen gjatë periudhës afatmesme dhe afatgjate. Sistemi i mbrojtjes është i organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesat, qëllimet, kapacitetet dhe konceptin strategjik të mbrojtjes.

Për qëllime të mbrojtjes së vendit dhe të zbatimit të skenarëve strategjikë të Republikës së Kosovës, supozohet se secili institucion përgjegjës për siguri dhe mbrojtje do të kryejë detyrat e tij në kuadër të sistemit të mbrojtjes, me përpikëri, në mënyrë efektive dhe efikase sipas kompetencave dhe përgjegjësive ligjore që kanë.

3.2. Prioritetet e Sistemit të Mbrojtjes

Republika e Kosovës synon të intensifikojë bashkëpunimin dhe ndërveprimin dypalësh dhe shumëpalësh në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Shteti ynë është i përkushtuar për krijimin e një mjedisi të sigurt brenda vendit, si dhe i gatshëm për të mbështetur me kapacitete të sigurisë dhe të mbrojtjes shtetet fqinje dhe partnerët. Kosova do të mbështesë edhe aleancat apo koalicionet ndërkombëtare në operacione ndërkombëtare të udhëhequra nga organizata ndërkombëtare, NATO-ja dhe partnerët strategjikë.

Përderisa prioritet kryesor për Ministrinë e Mbrojtjes është mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial, Ministria e Mbrojtjes do të vazhdojë të zhvillojë kapacitetet për pjesëmarrje në operacione ndërkombëtare dhe mbështetje ushtarake autoriteteve civile. Institucionet e Republikës së Kosovës, në situata emergjente shtetërore, si përgjigje ndërinstitucionale, ofrojnë aftësitë dhe kapacitetet në dispozicion për t'u përballur me to.

3.3. Elementet e sistemit të mbrojtjes dhe roli i tyre

Elementet e sistemit të mbrojtjes të Republikës së Kosovës janë të unifikuar, të strukturuar dhe funksionojnë në mënyrë të sinkronizuar sipas kompetencave dhe përgjegjësiwe ligjore që kanë.

Elementet themelore të sistemit të mbrojtjes në Republikën e Kosovës janë: Parlamenti, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria, Këshilli i Sigurisë i Kosovës, Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë e Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë dhe Agjencia e Menaxhimit Emergjent.

Kuvendi i Republikës së Kosovës miraton ligje, rezoluta dhe dokumente të tjera, përfshirë edhe Strategjinë e Sigurisë së Kosovës dhe Planin Afatgjatë Zhvillimor të FSK-së; ratifikon traktatet ndërkombëtare; miraton Buxhetin e Republikës së Kosovës; mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike; mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë; jep pëlqimin për dekretin e Presidentit mbi shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, krizës dhe luftës. Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Komisionit Parlamentarë për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes ushtron kontrollin parlamentarë dhe mbikëqyrjen e sundimit të ligjit mbi institucionet e sektorit të sigurisë.

Presidenti i Republikës së Kosovës - garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë; nxjerr dekrete në pajtim me Kushtetutën e RKS-së; shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës; ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj; nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me këtë Kushtetutë; udhëheq politikën e jashtme të vendit; pranon letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituar në Republikën e Kosovës; është Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës; emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës dhe gjeneralët e FSK-së; së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë; vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin; mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme; Në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme, Presidenti ka kompetenca të urdhërojë mobilizimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës; I jep udhëzimet Komandantit të FSK-së për mbikëqyrjen dhe sigurimin e ekzekutimit të të gjithë urdhrave të ligjshëm; miraton planet operationale për gjendjen e jashtëzakonshme të përgatitura nga ana e Komandantit të FSK-së.

Qeveria e Republikës së Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Qeveria zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, përcakton dhe drejton politikën e mbrojtjes; rekomandon Strategjinë e Sigurisë së Kosovës dhe miraton Strategjinë e Mbrojtjes; inicion Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë - RSSS dhe Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes - RSM; siguron fonde financiare apo resurse të tjera për nevojat e mbrojtjes.

Këshilli i Sigurisë i Kosovës, në bashkëpunim me Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë, përgatit Strategjinë e Sigurisë për Republikën e Kosovës. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës ka edhe rol këshillues në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në Republikën e Kosovës. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës kryesohet nga Kryeministri me mbështetje nga Qeveria, përveç gjatë periudhës së Gjendjes së Jashtëzakonshme, sikurse është parashikuar me Kushtetutë. Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme Presidenti i Republikës së Kosovës kryeson Këshillin e Sigurisë së Kosovës.

Ministria e Mbrojtjes propozon, harton dhe zbaton politikat e përgjithshme shtetërore të mbrojtjes në nivel strategjik. Ajo vlerëson kërcënimet, rreziqet dhe sfidat, si dhe i propozon Qeverisë miratimin e Strategjisë së Mbrojtjes dhe inicimin e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes. Ministria e Mbrojtjes përcakton drejtimet strategjike dhe, përmes politikave, akteve nënligjore, planeve zhvillimore dhe strategjive sektoriale të aprovuara nga Ministri i Mbrojtjes, drejton funksionimin, zhvillimin, profesionalizimin, modernizimin dhe standardizimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës. Ministri i Mbrojtjes ushtron kontroll civil demokratik mbi FSK-në në përputhje me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Forca e Sigurisë e Kosovës mbron sovranitetin dhe integritetin territorial, qytetarët, pronën dhe interesat e Republikës së Kosovës. Forca e Sigurisë e Kosovës është forcë ushtarake shumëetnike, profesionale dhe e autorizuar për të shërbyer në vend dhe jashtë vendit, në pajtim me kompetencat e dhëna kushtetuese dhe ligjore.

Policia e Republikës së Kosovës është organizatë profesioniste dhe pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Kosovës dhe mban përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Policia e Republikës së Kosovës ka zinxhir të unifikuar komandues në tërë Republikën e Kosovës, me stacione policore të cilat korrespondojnë me kufijtë komunalë.

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë zbulon, heton dhe mbikëqyr kërcënimet ndaj sigurisë në Republikën e Kosovës. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është profesioniste, politikisht e paanshme, shumëetnike dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Agjencia për Menaxhim Emergjent është agjencion brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe është përgjegjëse për koordinimin e reagimit ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. Disa nga detyrat kryesore të AME-së janë: është përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e sistemit të monitorimit dhe alarmit; elaboron vlerësimin e rrezikut dhe dokumentacionin teknik për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë; monitoron dhe raporton për kërcënime dhe jep udhëzime për trajtimin e tyre; në bashkëpunim me Ministrinë dhe Agjencitë Qeveritare, nën udhëheqjen e MPB-së, harton Planin për Reagimin Kombëtarë. AME kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

4. Zhvillimi dhe modernizimi i aftësive dhe kapaciteteve të mbrojtjes

Republika e Kosovës, si shtet sovran, zhvillon kapacitetet mbrojtëse duke respektuar mandatin dhe praninë e NATO-s në Kosovë. Për ngritjen e këtyre kapaciteteve, Republika e Kosovës do të bashkëpunojë ngushtë me partnerët strategjikë, NATO-n dhe KFOR-in. Në aspektin e ndërveprimit

shtetëror me NATO-n, Republika e Kosovës do të iniciojë, do të dialogojë dhe do të harmonizojë të gjitha veprimet që ndërlidhen për integrimin në NATO.

Zhvillimi i aftësive dhe kapaciteteve të mbrojtjes është proces i vazhdueshëm, gradual, i sinkronizuar nga shumë faktorë dhe në harmoni me projektet dhe planet zhvillimore. Mundësitë financiare do të përcaktojnë ritmin dhe kohëzgjatjen e zhvillimit dhe të modernizimit të institucioneve të sigurisë dhe të mbrojtjes në Republikën e Kosovës.

4.1. Kapacitetet e mbrojtjes

Ministria e Mbrojtjes zotohet se do të angazhohet në avancimin e aftësive dhe kapaciteteve për përmbushjen e misionit për t'iu përgjigjur të gjithë spektrit të kërcënimeve dhe rreziqeve ndaj vendit.

Aftësitë dhe kapacitetet kryesore që i duhen sistemit të mbrojtjes të Republikës së Kosovës janë:

- Aftësitë dhe kapacitetet për mbrojtjen e territorit nga agresioni i mundshëm konvencional;
- Aftësitë dhe kapacitetet për t'u përgjigjur në kërcënimeve hibride;
- Aftësitë dhe kapacitetet për përgjigje dhe menaxhim të operacioneve humanitare që shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu;
- Kapacitetet e komunikimit dhe të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që janë përgjegjëse për siguri dhe mbrojtje.
- Kapacitetet për pjesëmarrje në operacione ndërkombëtare
- Zhvillimi dhe avancimi i komponentës së Rezervës Aktive të FSK-së
- Aftësitë dhe kapacitetet për operacione ajrore dhe të mbrojtjes ajrore, në bashkëpunim me institucionet dhe agjencitë relevante me qëllim për të përgatitur Qeverinë e Kosovës (institucionet), për marrjen e mundshme të përgjegjësisë për kontroll.

Në këtë drejtim do të zhvillohet një Plan i Veprimit, që ofron udhëzime specifike se cilat detyra duhet të kompletohen dhe kur. Po ashtu, ky plan i veprimit do të përfshijë ndarjen e përgjegjësisë dhe përcakton se cili institucion apo organizatë është në udhëheqje dhe cilat institucione dhe organizata ofrojnë mbështetje, duke përfshirë edhe llojin e mbështetjes që do të sigurojnë.

Republika e Kosovës do të kontribuojë me kapacitete të specializuara (Deminim Humanitar - EOD, Kërkim-Shpëtim - KSH, Materie të Rrezikshme - MRR, Mjekësi dhe Xhenio Civile) për operacionet ndërkombëtare. Vendi ynë zotohet që t'i mbështesë partnerët dhe aleatët për ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Kjo listë nuk është përfundimtare dhe për çdo skenar dhe situatë të mundshme

kërcënimi apo rreziku, nga institucionet e vendit, do të përcaktohen edhe aftësitë dhe kapacitetet e nevojshme për reagim.

Ministrinë e Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, institucionet tjera përgjegjëse si dhe në harmoni me Strategjinë e Sigurisë së Kosovës, do ta zhvillojnë dhe do ta avancojnë Programin Edukativ Shtetëror për Siguri dhe Mbrojtje.

Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja do të zhvillojnë dhe avancojnë Qendrën Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike. Kjo qendër do të sigurojë edukim/trajnim profesional në fushën e sigurisë

kibernetike për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja do të vazhdojnë të zhvillojë dhe avancojë Qendrën Ndërkombëtare e Trajnimit për Kërkim - Shpëtim si kapacitet trajnues me qëllim të ngritjes së aftësisë profesionale në fushën e kërkim – shpëtimit.

Republika e Kosovës, inkurajon zhvillim të mundshëm ekonomik përmes industrisë së mbrojtjes i cili është shumë i rëndësishëm për vendin. Andaj, Ministria e Mbrojtjes dhe ministritë e tjera relevante, do të zhvillojnë kornizën e nevojshme ligjore në eksplorimin e mundësive për investime dhe zhvillim të industrisë së mbrojtjes

Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë e Kosovës do të fokusohen në avancimin e kapaciteteve të inteligjencës së mbrojtjes përmes themelimit të Agjencisë së Mbrojtjes për Inteligjencë dhe Siguri (AMIS). Kjo do të avancojë sigurinë fizike, sigurinë e informacionit, personelit, si dhe shkëmbimin e informacionit me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë. Ministria e Mbrojtjes dhe FSK, përmes AMIS, do të vendosin shkëmbim të privilegjuar të informatave me institucionet e sigurisë në Republikën e Kosovës, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kërcënimeve dhe rreziqeve që mund të cenojnë sigurinë e vendit tonë.

Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja do të kontribuojnë në zhvillimin dhe në ekzekutimin e programeve të de-radikalizimit të luftëtarëve të huaj, bazuar në Strategjinë shtetërore të Republikës së Kosovës kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

4.1.1. Ministria e Mbrojtjes

Ministria e Mbrojtjes është një organ i administratës shtetërore, i përbërë nga personeli civil dhe ushtarak. Ministri i Mbrojtjes është autoriteti më i lartë i drejtimit politik të Ministrisë dhe ushtron mbikëqyrje civile dhe demokratike, kontroll dhe administrim të përgjithshëm mbi FSK-në. Ministri i Mbrojtjes, inspekton Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, përmes Inspektorit Gjeneral. Përveç kësaj funksionalizimi i pozitës së komisionerit parlamentar (ombudspersonit), do të fuqizoj mbikëqyrjen civile dhe demokratike.

Ministria e Mbrojtjes, harton dhe zbaton politikat e përgjithshme shtetërore të mbrojtjes në nivelin strategjik, si dhe ushtron funksionet e kompetencat e saj, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Ministria e Mbrojtjes është përgjegjëse për dhënien e drejtimeve strategjike dhe mbikëqyrjen e tyre, në fushat e mëposhtme:

- Politikave dhe planifikimit të mbrojtjes;
- Buxhetit të mbrojtjes;
- Inteligjencës strategjike të Mbrojtjes;
- Komunikimit strategjik;
- Edukimit dhe trajnimit ushtarak dhe civil;
- Menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Logjistikë
- Blerje/prokurim
- Vlerësimin të arritjeve dhe sigurimit të rezultateve;
- Operacioneve ndërkombëtare;
- Bashkëpunimit ndërkombëtar të mbrojtjes dhe diplomacisë së mbrojtjes.

4.1.2. Forca e Sigurisë e Kosovës

Forca e Sigurisë e Kosovës mbron sovranitetin dhe integritetin territorial, qytetarët, pronën dhe interesat e Republikës së Kosovës. Forca e Sigurisë e Kosovës është forcë ushtarake shumëtnike, profesionale dhe e autorizuar për të shërbyer në vend dhe jashtë vendit, në pajtim me kompetencat e dhëna kushtetuese dhe ligjore.

Detyrat e përgjithshme të Forcës së Sigurisë të Kosovës janë:

- Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës;
- Mbështetja ushtarake e autoriteteve civile;
- Pjesëmarrja në operacionet ndërkombëtare.

FSK-ja vepron në tërë territorin e Republikës së Kosovës nëpërmjet zinxhirit të unifikuar komandues ushtarak dhe përbëhet nga Shtabi i Përgjithshëm, Komandat dhe Njësitë Vartëse të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së.

Forca e Sigurisë e Kosovës, luan rol kryesor në secilin prej pesë objektivave të Strategjisë së Mbrojtjes:

Objektivi i parë i Strategjisë së Mbrojtjes - Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit. FSK-ja do të zhvillohet dhe konsolidohet në vazhdimësi si forcë profesionale dhe e ndërveprueshme me forcat partnere. Zhvillimi i Forcës së Sigurisë të Kosovës mbështetet në Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit dhe në Planin Afatgjatë Zhvillimor.

Strukturat kryesore të luftimit e të mbështetjes do të jenë në nivel regjimenti, ndërkohë që **struktura bazë** e luftimit dhe mbështetjes do të jetë në nivel kompanie ose të barasvlershëm me të. Njësitë e FSK-së mund të organizohen edhe si "forcë për detyrë", niveli i të cilave do të varet nga detyrat dhe natyrat e misioneve në të cilat do të angazhohen. Forca e Sigurisë e Kosovës do të ngre dhe do të zhvillojë edhe më tej aftësitë dhe kapacitetet për të vepruar së bashku me forcat ushtarake të NATO-s, bazuar në standarde vendore dhe të NATO-s, aty ku janë të aplikueshme.

Objektivi i dytë i Strategjisë së Mbrojtjes - Modernizimi dhe avancimi i kapaciteteve ushtarake - FSK-ja do ta mbështesë këtë objektiv përmes zhvillimit bazuar në kombinimin dhe përputhshmërinë e sistemeve, teknikës dhe pajisjeve në përdorim.

Krahas rritjes së shpenzimeve për investime, do të zbatohet një politikë e qartë për të rregulluar balancën e shpenzimeve të modernizimit të sistemeve, pajisjeve dhe infrastrukturës bazuar në resurset në dispozicion.

Sistemi i mbrojtjes në Republikën e Kosovës ka për qëllim që të sigurojë aftësitë dhe kapacitetet, si në vijim:

- Të planifikojë, të drejtojë dhe të kryejë operacione **frenuese** dhe mbrojtëse në të gjithë territorin e vendit
- Të ruajë dhe të zhvillojë mbështetjen aktuale autoriteteve civile gjatë situatave emergjente, dhe
- Të sigurojë aftësi dhe kapacitete ushtarake në nivel togu për të mbështetur operacionet ndërkombëtare, gjatë kohës kur nuk kemi gjendje krize apo lufte.

Objektivi i tretë i Strategjisë së Mbrojtjes - Rritja e ndërveprueshmërisë ndërinstitucionale. FSK-ja do të mbajë dhe do të zhvillojë në vazhdimësi aftësitë dhe kapacitetet për mbështetje ushtarake autoriteteve civile. Qendra fuzionuese ndërinstitucionale do të jetë përgjegjëse për bashkërendimin, komunikimin dhe bashkëpunimin e veprimtarive ndërinstitucionale në situata emergjente, krize dhe lufte.

Bashkëpunimi ndërinstitucional është i rëndësishëm edhe në luftimin e veprimtarive propaganduese të shërbimeve të jashtme. Krijimi i platformës ndërinstitucionale për identifikimin dhe ekspozimin e ndërhyrjeve të jashtme armiqësore do të ndihmojë në paralajmërimin e hershëm, adresimin e këtyre kërcënimeve dhe vetëdijesimin e qytetarëve.

Objektivi i katërt i Strategjisë së Mbrojtjes - Zgjerimi i bashkëpunimit bilateral, anëtarësimi në organizata dhe pjesëmarrja në operacione ndërkombëtare. Ministria e Mbrojtjes ka objektiv zgjerimin e bashkëpunimit bilateral. Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe marrëveshjeve SOFA që kanë ndodhur dhe ato që janë në proces, e afirmojnë partneritetin dhe rrisin besimin reciprok me vende tjera. Përmes këtyre marrëveshjeve, MM dëshmon që mekanizmat e sigurisë në Kosovë janë të përgatitur dhe të gatshëm si në aspektin organizativ ashtu edhe funksional të ndërveprojnë me partneret drejt qëllimit final - anëtarësimi të

Kosovës në NATO. MM përmes mekanizmave përkatës, do të angazhohet edhe më shumë në rritjen e marrëveshjeve MoU-ve, SOFA dhe marrëveshjeve të ndryshme teknike, me qëllim të rritjes së ndërveprueshmërisë në stërvitje, trajnime, ushtrime dhe shkëmbim të përvojave të FSK-së me ushtritë e vendeve tjera. Zgjerimi i bashkëpunimit bilateral e ngrite MM-në dhe FSK-në në një nivel edhe më të lartë dhe i jep avantazhin e ngritjes së përvojave të reja në fushën e sigurisë globale.

Një nga qëllimet e MM-së është që FSK të jetë e gatshme dhe e aftë që së bashku me ushtritë e vendeve aleate dhe partnere të zbarkoi në operacione ndërkombëtare. Përmes zbarkimeve të përbashkëta, dëshmohet aftësia e FSK-së për të operuar brenda standardeve dhe procedurave të NATO-s dhe mekanizmave tjerë të sigurisë dhe e ofron vendin tonë edhe më shumë drejt aleancës me NATO-n. FSK ka kapacitete operationale dhe taktike për misione zbarkimi dhe kjo është dëshmuar në bashkë-zbarkimet jashtë vendit.

Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare është qëllim i Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa sa i përket fushës së mbrojtjes dhe sigurisë ai përkthehet në pjesëmarrjen e MM-së në iniciativa dhe forume të ndryshme të mbrojtjes dhe sigurisë. Në këtë drejtim, një nga qëllimet është anëtarësimi i RKS-së në Kartën e Afriatikut (A5), e që do të ishte një udhërrëfyes drejt Pfp (Partnership for Peace). Gjithashtu është me rëndësi koordinimi me partnerët për të ndihmuar në anëtarësimin e RKS-së në format të plotë të pjesëmarrjes në forume tjera si **SEDM** (South – Eastern Europe Defence Ministerial) , **RCC** (Regional Cooperation Council), **RACVIAC** (Regional Arms Control Verification and Implementation Assistance Centre), Forumi i Gracit, etj.

Objektivi i pestë i Strategjisë së Mbrojtjes - Avancimi i bashkëpunimit me NATO-në dhe mekanizmat e saj në Kosovë – Ministria e Mbrojtjes ka bashkëpunim të mirë me NATO-n, përmes zyrës së **NALT-it** (NATO Advisory and Liaison Team), të cilët në vazhdimësi monitorojnë dhe këshillojnë në fushat përkatëse brenda MM-së. Republika e Kosovës, gjithashtu edhe përmes përfaqësuesit ndërlidhës i njofton ambasadorët dhe përfaqësuesit e vendeve anëtare në NATO, me të arriturat, angazhimet dhe qëllimet e RKS-së drejt rrugës në NATO. Është me rëndësi që të punohet me të gjitha vendet anëtare të NATO-s për të krijuar një mundësi praktike që RKS-së t'i hapet rruga drejt NATO-s përmes Pfp. MM ka bashkëpunim të shkëlqyer edhe me misionin e KFOR-it në Kosovë, dhe përmes zyrave ndërlidhëse informojnë dhe koordinojnë për aktivitetet e planifikuara dhe realizohen edhe ushtrime të ndryshme të përbashkëta mes FSK-së dhe KFOR-it. Ky bashkëpunim duhet të vazhdoi pasi që e rritë ndërveprueshmërinë dhe ofron siguri për Kosovën.

4.2 Zhvillimi dhe modernizimi i Sistemit të Mbrojtjes

Republika e Kosovës është duke i zhvilluar aftësitë dhe kapacitetet për mbrojtje të integritetit territorial. Andaj, Forca e Sigurisë e Kosovës, në raport me zhvillimin e aftësive të saj, është prioritet kryesor në periudhën afatmesme.

Rishikimi i prioriteteve për zhvillim dhe modernizim do të bëhet varësisht nga vlerësimi strategjik i kërcënimeve, rreziqeve dhe mundësive të Republikës së Kosovës për të riorganizuar dhe përcaktuar prioritetet e zhvillimit dhe të modernizimit të institucioneve të mbrojtjes dhe të sigurisë. Të gjitha institucionet e vendit të orientojnë zhvillimin dhe modernizimin e tyre bazuar në nevojat për të kontribuar në sistemin e mbrojtjes të Republikës së Kosovës.

Zhvillimi dhe modernizimi i aftësive dhe kapaciteteve të bëhet në sinkronizim me parimet dhe procedurat e përcaktuara, në atë mënyrë që institucionet të jenë në gjendje të ndërveprojnë dhe të operojnë gjatë situatave të reagimit të përbashkët.

5. Burimet dhe buxheti i mbrojtjes

Përdorimi i duhur i burimeve të mbrojtjes ka ndikim të rëndësishëm në funksionimin efektiv të sistemit të mbrojtjes në Republikën e Kosovës. Elementet kryesore të burimeve të mbrojtjes janë: **burimet njerëzore, materiale dhe financiare**. Burimet e mbrojtjes mundësojnë realizimin e misionit dhe detyrave themelore të institucioneve të mbrojtjes dhe të sigurisë.

Burime njerëzore janë aset kryesor për zhvillimin e sistemit të suksesshëm të mbrojtjes në Republikën e Kosovës. Në këtë drejtim, është e nevojshme të avancohet niveli i edukimit/trajnit të burimeve njerëzore, duke përdorur edhe mekanizma të bashkëpunimit ndërkombëtar. Andaj, me qëllim të adaptimit të praktikave më të mira, do të zhvillohen politika më të avancuara për rekrutim të personelit ushtarak aktiv, rezervë dhe stafit civil, në mënyrë që të krijohen kushte për zhvillimin e një force profesionale moderne. Rreziqet dhe kërcënimet e reja të sigurisë kërkojnë aftësi të reja dhe trajnim modern. Për këtë qëllim, theksi vihet në përgatitjen e personelit profesional ushtarak, rezervë dhe civil, të arsimuar dhe të trajnuar mirë, të aftë dhe të motivuar. Në vazhdimësi, në bashkëpunim me partnerët strategjik do të zhvillohen analiza dhe vlerësime të fizibilitetit për të gjeneruar opsione për modele të shërbimit ushtarak, bazuar në kushtet, rrethanat dhe resurset.

Rekrutimi i stafit ushtarak dhe civil do të jetë konkurrues në tregun e punës, duke ofruar pagë, përfitime dhe kompensime të tjera sipas kërkesave për shërbimin ushtarak dhe civil. Trendët e tanishëm demografikë kërkojnë angazhim të shtuar, për të siguruar që politikat e tërheqjes, rekrutimit dhe të mbajtjes së personelit të arrijnë standardet e kërkuara për forcat tona, duke u dhënë përparësi individëve me arsimim më të lartë dhe me aftësi e cilësi unike për specialitete të veçanta. Forca e Sigurisë e Kosovës është forcë shumetnike, andaj në këtë drejtim do t'i jepet përparësi përfaqësimit gjinor në përputhje me qëllimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Integriteti i institucioneve të mbrojtjes dhe personelit të tyre janë me rëndësi të veçantë dhe do të adresohen përmes planeve të integritetit. Implementimi i këtyre planeve do të ndikojë në rritjen e efikasitetit, transparencës dhe luftimit të korrupsionit që nga planifikimi, prokurimi, buxheti dhe ekzekutimi. Aspektet e menaxhimit të resurseve njerëzore, tërheqja, seleksionimi, arsimimi, trajnimi, motivimi, shpërblimi, avancimi dhe ndërprerja e shërbimit kontribuojnë në zhvillimin e suksesshëm dhe në mirëmbajtjen e forcave dhe aftësive operacionale, si dhe në shërbimin civil.

Burimet materiale dhe financiare - përfshijnë burimet natyrore, ekonomike, financiare, energjetike, informacionin dhe kapacitete të tjera të Republikës së Kosovës të angazhuara për nevoja të mbrojtjes. Burimet materiale për nevoja të sigurisë dhe të mbrojtjes planifikohen dhe përdoren në mënyrë transparente në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës. Strategjia e Mbrojtjes inkurajon institucionet e sistemit të mbrojtjes që me prioritet të mbështesin zhvillimin dhe modernizimin e aftësive dhe kapaciteteve të sigurisë dhe të mbrojtjes.

Buxheti i Republikës së Kosovës dhe mbështetja nga partnerët janë bazë që përcaktojnë zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve të mbrojtjes. Qeveria dhe Parlamenti i Republikës së Kosovës do të marrin për bazë prioritetet dhe elementet e mbrojtjes për mbështetje me fonde dhe resurse të tjera. Fatkeqësitë e ndryshme, sëmundjet ngjithëse, si dhe ngjarjet që kanë ndikim në ekonomi, mund të ndikojnë drejtpërdrejt në ngadalësimin e zhvillimit të kapaciteteve apo humbjen e kapaciteteve ekzistuese si pasojë e riorientimit të prioriteteve.

Tranzicioni i FSK-së dhe dinamika në realizimin e planeve për pajisje gjatë viteve të fundit dhe në periudhën e ardhshme do të realizohen përmes rritjes graduale të buxhetit të mbrojtjes. Në raport me buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, Republika e Kosovës synon të arrijë objektivat e shpenzimit për mbrojtje (FSK) në minimum 2% të BPV-së, siç është cekur në Strategjinë e Sigurisë së Kosovës. Rritja e buxhetit duhet të jetë e balancuar në mes të kategorive kryesore shpenzuese, me qëllim të arritjes të objektivave të ndryshme, përfshirë profesionalizimin e plotë të FSK-së, mirëmbajtje më të mirë të pajisjeve, avancim të arsimit dhe të trajnimit, zhvillim të standardizimit dhe të modernizimit, si dhe rritje të vazhdueshme të aftësive për zbatim të misionit.

Institucionet e mbrojtjes dhe të sigurisë kryejnë misionet, detyrat dhe funksionet e tyre kryesore, duke i shfrytëzuar të gjitha resurset me të cilat disponojnë. Qeveria e Republikës së Kosovës do të zhvillojë strategji fiskale, reprezentative dhe të definuar mirë.

6. Përfundim

Prioriteti ynë është ta mbrojmë Kosovën dhe të mbajmë të gjithë qytetarët e saj të sigurt, për të parandaluar dhe për të zbrapsur konfliktin. Por, nëse gjithçka tjetër dështon, duhet të jemi të përgatitur për të luftuar. Si një shtet sovran, anëtarësimi në NATO dhe në komunitetin e gjerë euroatlantik mbeten në zemër të aspiratave tona për sigurinë dhe mbrojtjen, siç e bën të qartë edhe Strategjia e Sigurisë e Kosovës. Kosova do të jetë e sigurt dhe e mbrojtur vetëm atëherë kur rajoni ynë të jetë i sigurt dhe i mbrojtur.

Strategjia e Mbrojtjes mbështet ambicien dhe drejtimin e Strategjisë së Sigurisë të Kosovës. Ajo përshkruan: pozicionin tonë aktual të mbrojtjes; kërcënimet dhe mundësitë me të cilat përballemi dhe strukturat për t'i adresuar ato. Sistemi i Mbrojtjes kërkon që të gjitha institucionet përkatëse të punojnë së bashku në mënyrë të organizuar, nën një strukturë të fuqishme qeverisëse, në mbrojtjen e Kosovës, interesave dhe vlerave të saj.

Strategjia e Mbrojtjes ofron udhëzime për zhvillimin e ardhshëm dhe për transformimin e vazhdueshëm të mbrojtjes, me qëllimin e krijimit të një force të ndërveprueshme dhe të gatshme të NATO-s. Ajo shpjegon se Kosova do të jetë një kontribues rajonal i sigurisë dhe një pjesëmarrës në operacionet ndërkombëtare mbështetëse humanitare dhe paqësore dhe shpreh qëllimin e Kosovës për të financuar mbrojtjen në një nivel të duhur, në përputhje me aspiratat tona të anëtarësimit në NATO.

Strategjia e Mbrojtjes përcakton se FSK-ja është dhe do të jetë një ofrues i sigurisë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Po ashtu, strategjia përcakton madhësinë dhe formën e planifikuar të MM-së dhe FSK-së.

Gjithashtu, Strategjia e Mbrojtjes do të mbështetet me Plan të Veprimit të Strategjisë së Mbrojtjes, i cili obligon Ministrinë e Mbrojtjes, që përmes Departamentit për Politika dhe Strategji, të monitorojë dhe të vlerësojë zbatimin e progresit përmes raporteve gjashtë mujore dhe vjetore.

Strategjia e Mbrojtjes do të rishikohet sipas nevojës, për t'u siguruar që ajo të mbetet e sinkronizuar me objektivat e Strategjisë së Sigurisë të Kosovës, përshtatshmërinë dhe përballueshmërinë me situatën e gjerë të sigurisë.